

Udhëzues për përdorimin e Abetares

Paketa e Abetares është përgatitur nga një grup specialistësh didaktikë dhe gjuhëtarësh nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Ajo është mbështetur në programet e Ministrive të Arsimit të këtyre vendeve. Qëllimi i grupit të punës ka qenë të përgatisin një paketë sa më të plotë që do t'u shërbejë nxënësve në shkolla, si dhe fëmijëve që do ta përdorin këtë paketë edhe në mjedisin familjar. Paketa synon që mësimi i gjuhës shqipe të jepet në mënyrë sa më zbatimëse, tërheqëse dhe të përvetësueshme, duke harmonizuar të pesë proceset bazë: të vëzhguarit, të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Në paketa është:



- Teksti bazë *Abetare*, i strukturuar me tri pjesë: Paraabetare, Abetare, Pasabetare.



- *Fletorja e modeluar*, ku nxënësit sipas modelit do të ushtrohen të shkruajnë shkronjat e dorës.



- *Fletorja e punës*, ku nxënësi do të ushtrohet për mësimin e shkronjave, kryesisht të shtypit dhe të disa njohurive gramatikore.



- *DVD-ja*, e cila si mjet audio-vizual u shërben nxënësve për t'u ushtruar në proceset e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit.



- *Fjalor i ilustruar*. (shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht); paketa përmban një prej tyre. Synimi ynë ka qenë që fjalorët t'u shërbejnë edhe fëmijëve që jetojnë jashtë vendit të tyre.

ba	bi	ce	cu	çi	çe
di	do	dhe	dhu	fi	f
gi	go	gje	gj	h	
ja	je	ka	ku		
lli	llo	ma	mi		
njo	nje	pi	pa		

a	b	c	ç	d	dh
e	ë	f	g	gj	h
i	j	k	l	ll	m
n	nj	o	p	q	r
rr	s	sh	t	th	u
v	x	xh	y	z	zh

Aa	Bb	Cc	Çç	Dd	DHdh
Ee	Ëë	Ff	Gg	GJgj	Hh
Ii	Jj	Kk	Ll	Ll	Mm
Nn	NJnj	Oo	Pp	Qq	Rr
RRrr	Ss	SHsh	Tt	THth	Uu
Vv	Xx	XHxh	Yy	Zz	ZHzh



- *Xhepi i shkronjave dhe i rrokjeve*.

- *Mozaiku me vjersha për secilën shkronjë*.

a. Disa sugjerime për përdorimin e paketës së Abetares (për prindërit dhe mësuesit)

Të gjithë aksesoret që përmban paketa, shoqërojnë tekstin bazë, që është ABETARJA; për një të mësuar sa më aktiv dhe tërheqës për fëmijët e kësaj moshe, ata duhet të përdoren të gjithë dhe në mënyrë të gërshtuar.

Në DVD janë të realizuara:

- dialogët ndërmjet personazheve: Anës, Lulit, Bubit dhe Rokit, në mësimet e *paraabetares* dhe të abetares,
- demonstron mënyra se si shkruhen shkronjat e dorës,
- kënga për secilën shkronjë,
- kënga "Himni i flamurit",
- kënga himn e abetares "Gjuha e nënës" që mbyll DVD-në.

a. Libri "Abetare" fillon me prezantimin e personazheve dhe vazhdon me aktivitetet e tyre, që do të shoqërojnë nxënësit në çdo mësim. Rekomandohet që punimi i faqeve të para të librit të fillojë me vëzhgimin e hollësishëm nga ana e nxënësve të figurave që shohin aty. Mësuesi/prindi nëpërmjet pyetjeve nxit dhe rrit interesin e tyre, për informacionin e paraqitur. P.sh.:

- 1- Çfarë shikoni në figurë?
- 2- Sa njerëz shikoni?
- 3- Sa kafshë?
- 4- Çfarë tregohet në këtë figurë? (për robotin)
- 5- Çfarë dini për robotët?
- 6- Si janë veshur miqtë tanë? ... etj.



Pasi fëmijët kanë parë e folur për personazhet, mësuesi/prindi përsëri drejton vëmendjen e tyre te fjalët e qarkuara. Mund të pyetet:

- Çfarë mendoni se po thotë vajza?
- Po djali?
- Pse roboti jeton me ta?
- A kanë fëmijët emra?

Mësuesi/prindi u sqaron fëmijëve se, ashtu sikurse ata, edhe personazhet që shohin në figura kanë emra.

Kështu vajza thotë: "Unë jam Ana."

Qeni thotë: "Ham - ham, jam Bubi."

Kurse roboti: "Ro - ki."

Djali thotë: "Unë jam Luli."

Këto fjali prezantuese është mirë të jenë shkruar në rripa letre dhe t'u jepen nxënësve t'i shikojnë dhe të gjejnë ku shkruhet fjala Ana e ku Luli, ku Roki e ku Bubi.

Mësuesi i ndihmon nxënësit të njihen dhe të familjarizohen me njëri-tjetrin, si dhe të përdorin fjalë e fjali që lidhen me prezantimin.

b. Për **gjashtë mësimet e para**, përveçse në tekst, mësuesi/ja a prindi do t'i gjejë temat dhe në formën elektronike. Për shembull, nëse tema e mësimit është "Në fshat", në DVD gjendet e njëjta pamje e figurës së librit, e shoqëruar me dialogun ndërmjet personazheve tona, kur janë në fshat dhe me shqiptimin e saktë të fjalëve që emërtojnë objektet e dhëna, p.sh., *traktor, pulë, fushë, gardh* etj.

DVD-ja punohet paralelisht me tekstin.



c. Për mësimin e çdo shkronje do të ndiqen këta hapa:

Hapi I. Mësimi i shkronjës fillon me paraqitjen e figurës, tekstit dhe dialogun e personazheve që gjenden në DVD-i dhe janë të njëjta me faqen përkatëse të Abetares.

Nxënësit dëgjojnë shqiptimin e drejtë të tingullit, dialogun ose tekstin e dhënë, i cili përmban fjalë me tingullin (shkronjën) që mësohet dhe shikojnë dhe njohin grafikën e shkronjës të madhe dhe të vogël të shtypit, si dhe njihen globalisht me fjalët. Personazhet fëmijë shërbejnë për të ngulitur shqiptimin e drejtë dhe me intonacionin e duhur të tingullit, fjalës dhe fjalisë. Personazhi i Rokit shërben për t'i ndarë fjalët në rrokje, si dhe për të dalluar shkronjën nga rrokja dhe rrokjen nga fjalia.

Hapi II. Më pas kalohet në leximin e tekstit dhe plotësimin e ushtrimeve.

Në këtë etapë, kur nxënësit nuk i njohin si duhet shkronjat, i kushtohet rëndësi e madhe dallimit dhe ngulitjes së grafikës së shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit. Pavarësisht se nxënësit nuk i lexojnë fjalët, ata i fotografojnë ato si një e tërë. Në këtë etapë i vihet rëndësi ushtrimeve për të dalluar shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit, e cila mund të gjendet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Figurat ndihmojnë për të përvetësuar dhe pasuruar fjalorin me sa më shumë fjalë, ku gjendet kjo shkronjë.

Hapi III. Paraqitet grafikisht shkronja e madhe dhe e vogël e dorës. Modelimi i shkronjave gjendet fillimisht në DVD-i, ku nxënësi shikon se si modelohet hap pas hapi shkronja dhe më pas ushtrohet në fletoren e modeluar.


Hapi IV. Punohen në Abetare ushtrimet e faqes së dytë të shkronjës përkatëse, ku nxënësit vazhdojnë të praktikojnë shkronjën e mësuar nëpërmjet leximit të teksteve apo vjershave. Në këtë faqe ka ushtrime me karakter gramatikor, ku nxënësit, në mënyrë intuitive, plotësojnë dhe dallojnë fjalën nga fjalia, gjininë mashkullore nga ajo femërore, numrin njëjës nga numri shumës etj.

Hapi V. Punimi i fletës së punës. Çdo shkronje i përgjigjet një faqe e kësaj fletoreje. Aty nxënësit ushtrohen të dallojnë, të shkruajnë dhe të plotësojnë shkronjën përkatëse, si dhe të zbatimen me vizatime të ndryshme.



Hapi VI. Me shkronjat dhe rrokjet që gjenden te xhepi fëmijët do të ushtrohen të shkruajnë në mënyrë globale disa nga fjalët që shohin në libër, ku përfshihet shkronja përkatëse që është duke u mësuar.



Hapi VII. Kënga e shkronjës. Kjo këngë gjendet në DVD-i dhe u kërkohet nxënësve të mësojnë fjalët dhe të këndojnë këngën. Kjo etapë është argëtuese dhe ndihmon procesin e përvetësimit të shkronjës.



Hapi VIII. Me fletën që përmban secilën shkronjë, fëmijët do të fiksojnë anën grafike të shkronjës që mësojnë, si dhe do të lexojnë me ndihmën e mësuesit/prindit vjershën e shkronjës përkatëse, derisa ta mësojnë atë përmendsh.



Të gjithë komponentët e kësaj pakete i ndihmojnë fëmijët e kësaj moshe, si një pjesë e pandashme e tekstit, por dhe si një formë e re e bashkëkohore për perceptimin dhe mësimin e shkronjave të alfabetit tonë, me qëllimin për të lexuar e për të shkruar sa më shpejt e sa më bukur leximin dhe shkrimin e gjuhën shqipe.

b. Disa sugjerime për mësuesit që do ta zhvillojnë këtë paketë gjatë një viti shkollor

Teksti *Abetare* është hartuar në përputhje me programin e kësaj lënde.

Përmbajtja e kësaj lënde zhvillohet nëpërmjet integritit të pesë linjave: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, të vëzhguarit. Të gjitha këto linja mbështeten te njohuritë gjuhësore të parashikuara në program.

Teksti është konceptuar si një vazhdim i natyrshëm i njohurive që kanë marrë nxënësit në arsimin parashkollor. Konkretisht si vazhdimësi e paketës së botuar nga Albas "Një hap drejt shkollës". Në këtë paketë nxënësit janë parapërgatitur për të dalluar tingujt nga shkronjat, për të mësuar fjalën në mënyrë globale, kanë pasuruar fjalorin dhe janë ushtruar në elemente të veçanta të shkrimit me anë të vizatimit.

Teksti i *Abetares* është ndërtuar me tri pjesë, ku secila prej tyre i përkon një periudhe të caktuar të programit dhe realizon objektivat e përgjithshëm dhe specifike të lëndës.

Pjesa I - Miqtë tanë

Periudha përgatitore

- Paraabetare -	4 javë x 8 orë = 32 orë
Zhvillimi i të folurit	16 orë
Njohja me elementet e shkrimit	16 orë

Pjesa II - Roki shkruan dhe lexon

Periudha e Abetares 26 javë x 8 orë = 208 orë

Lexim e shkrim	36 shkronja x 5 orë = 180 orë
Përsëritje (rimarrje)	6 x 4 orë = 24 orë
Orë të lira	4 orë

Pjesa III - Eja tek unë (Në botën e librave)

Periudha e Pasabetares 5 javë x 8 orë = 40 orë

Veprimtari leximi	18 orë
Ushtrime gjuhësore	18 orë
Orë të lira	4 orë

Pjesa e parë shërben si paraabeta, ku nxënësit parapërgatiten për fazën e dytë të leximi-shkrimit. Kjo fazë ka si objektivi t'u zhvillojë nxënësve të dëgjuarit dhe të folurit dhe t'i njohë me elementet e shkrimit.

Disa nga objektivat specifike të kësaj faze janë:

A. Të flasë qartë e saktë në gjuhën shqipe;

- të artikulojë qartë tingujt dhe të shqiptojë drejt fjalët;
- të flasë rreth figurave që sheh në libër.
- të pasurojë në vazhdimësi fjalorin dhe ta përdorë atë në situatat e dhëna.

B. Të dëgjojë në grupe të vogla dhe të mëdha;


- Të dëgjojë me vëmendje dhe t'u përgjigjet bashkëfolësve brenda temës për të cilën flitet;
- Të tregojë vëmendje gjatë bisedave që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e tij;
- Të hyjë në bashkëbisedim me të tjerë bashkëfolës, bashkëmoshatarë dhe të rritur.

c. Të fitojë shprehitë e teknikës të të lexuarit dhe të shkruarit.

- Të lidhë tingullin me shkronjën përkatëse;
- Të fitojë shkathësi për të shkruar elemente të veçanta të shkronjave të shtypit.
- Të lexojë globalisht fjalë të tilla, si: *dritare, liqen, traktor, qytet.*

Në pjesën e parë që fillon me prezantimin e katër personazheve: Anës, Bubit, Lulit dhe Rokit (robotit), gërshetohen elementet e të folurit dhe të dëgjuarit me ushtrimin e elementeve të shkrimit. Nxënësi

mëson të flasë për mjediset që e rrethojnë, si: shtëpia, klasa, parku, dyqani etj. mjedise të afërta e të njohura prej tij. Ai përsërit dhe mëson fjalë të reja, të cilat i fotografon dhe i lexon globalisht. Kjo pjesë e fut natyrshëm nxënësin në procesin e të mësuarit. Shkrimi i elementeve të shkronjave bëhet fillimisht me anë të vizatimit, me figura që kanë elementet e shkronjave, me qëllim që nxënësi të kalojë natyrshëm në mësimin e grafikës së çdo shkronje, të fjalëve dhe më pas të fjalive. Këto shkronja janë të grupuara sipas llojeve të vijave: të harkuara e të rrumbullakosura, të drejta, të prera apo me zigzage.




Pjesa e dytë është parashikuar të zhvillohet në 36 njësi mësimore, ku në çdo njësi do të përvetësohet një shkronjë. Njësia mësimore mund të zhvillohet në 5 orë ose sa e sheh të arsyeshme mësuesi në përputhje me programin dhe nivelin e klasës.

Struktura e njësisë mësimore përbëhet nga:

- Paraqitja e tingullit dhe e shkronjës.
- Grafika e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit dhe të dorës.
- Të ushtruarit në të lexuar.
- Të ushtruarit në të shkruar.

Pas studimit të 6 -7 shkronjave është parashikuar të zhvillohet një orë përsëritjeje.



Për mësimin e leximi-shkrimit ndiqet parimi global duke u gërrshetur edhe me parimin analitik-sintetik. Nxënësit pasi e lexojnë fjalën globalisht, bëjnë dhe analizën strukturore të fjalës, duke analizuar përbërësit: shkronjën dhe rrokjen.

Veprimet e katër personazheve, që vendosen në situata të larmishme, të këndshme duke bashkëvepruar natyrshëm me njëri-tjetrin, e bëjnë mësimin tërheqës dhe zbatimës. Kështu nxënësi e gjen veten në një mjedis sa më afër moshës.

Në këtë pjesë, realizohen qëllimet kryesore të programit. Nxënësi nxitet për dëgjim aktiv dhe racional; aftësohet të nyjëtojë drejt fjalë dhe fjali; të përvetësojë dhe të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës, të lexojë fjalë, fjali dhe tekste të shkurtra; të zbatojë normën standarde të gjuhës shqipe etj.



Disa nga objektivat specifike të kësaj pjese, të ndara sipas linjave janë:

A. Të dëgjuarit dhe të folurit

- Të identifikojë tinguj, rrokjet, fjalët dhe t'i shqiptojë si duhet.
- Të ndërtojë mirë fjalitë dhe t'i shqiptojë me intonacionin e duhur.
- Të lexojë në mënyrë të pavarur dhe me intonacionin e duhur.
- Të respektojë gjatë leximit shenjat e pikësimit, si: pika, presja, pikëpyetja, pikëçuditja.
- Të lexojë me intonacionin e duhur fjalinë dëftore, pyetëse dhe nxitëse.
- Të bëjë pyetje dhe të jetë në gjendje t'u përgjigjet.

- Të marrë pjesë aktivisht në proceset e komunikimit dhe të shprehë ndjenjat e emocionet e tij.

A. Të lexuarit

- Të lexojë në mënyrë globale tekstet me fjalët e njohura dhe të panjohura.
- Të ndajë tekstin në fjali dhe fjalë.
- Të dallojë bashkëtingëlloret dhe zanoret.
- Të njohë dhe të thotë përmendësh shkronjat e alfabetit.
- Të lexojë saktë shkronjat dyshe të alfabetit.
- Të lexojë në mënyrë të vetëdijshme tekste të ndryshme.
- Të dallojë shkronjën nga rrokja.
- Të dallojë tekstin nga fjalia dhe fjala.

C. Të shkruarit

- Të shkruajë saktë shkronjat e mëdha e të vogla të shtypit dhe të dorës.
- Të ndajë fjalët në rrokje.
- Të plotësojë fjalët në vendet ku mungojnë.
- Të përdorë shenjat e pikësimit: pikën dhe pikëçuditjen.
- Të përdorë shkronjën e madhe tek emrat e përveçëm të njerëzve.
- Të përdorë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.
- Të shkruajë me të diktuar fjali dhe paragrafë të thjeshtë.
- Të shkruajë letra dhe kartolina të thjeshta, duke parë dhe kopjuar.

D. Njohuri gjuhësore

- Të dallojë sipas intonacionit fjalinë dëftore dhe pyetëse.
- Të dallojë fjalinë pohore dhe mohore.
- Të dallojë numrin e emrave: kur janë në njëjës apo shumës.
- Të dallojë gjininë e emrave: femërorë apo mashkullorë.
- Të dallojë emrat e përgjithshëm nga emrat e përveçëm: të njerëzve, të kafshëve dhe të sendeve.

- Të gjejë dhe të përdorë mbiemra për të përshkruar njerëz, sende, kafshë.
- Të dallojë intuitivisht kohët e foljes (fjalë që tregojnë veprime që janë kryer me parë, kryhen tani, dhe do të kryhen më pas).
- Të përdorë intuitivisht përemrat vetorë etj.

Njohuritë gjuhësorë, të parashikuara në program, si dhe përdorimi i shenjave të pikësimit, janë shkruar në mënyrë të natyrshme gjatë gjithë tekstit.

Pjesa e tretë *Ejani tek unë* ka si objektiv përvetësimin sa më mirë të lexim-shkrimit. Tekstet janë zgjedhur dhe grupuar në mënyrë që ta ndihmojnë nxënësin të përvetësojë sa më mirë leximin, të pasurojë fjalorin, t'i përdorë fjalët e reja në situata të tjera, të ritregojë me fjalët e veta atë që lexon, duke siguruar një lexim të vetëdijshëm.



Çdo pjesë leximi shoqërohet me aparatën pedagogjik, i cili në radhë të parë synon ushtrimin në leximin dhe kuptimin e pjesës, pasurimin e fjalorit dhe ushtrimin në të shkruar.

Disa nga objektivat e kësaj pjesë janë:

- Të **flasë** saktë e në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër.
- Të ndërtojë mirë fjalitë dhe t'i shqiptojë me intonacionin e duhur.
- Të marrë pjesë aktivisht në proceset e komunikimit dhe të shprehë ndjenjat e emocionet e tij.
- Të **lexojë** në mënyrë të pavarur dhe me intonacionin e duhur.

- Të respektojë gjatë leximit shenjat e pikësimit, si: pika, presja, pikëpyetja, pikëçuditja.
- Të dallojë në një krijim letrar personazhet, vendin dhe kohën kur zhvillohen ngjarjet.
- Të përshkruajë përvoja vetjake.
- Të **shkruajë** fjali dhe tekste shumë të shkurtra.
- Të dallojë intuitivisht lloje të thjeshta tekstesh, si: prozën, vjershën, fjalët e urta.

Koha ikën

Koha ikën e shkon,
tik-tak, tik-tak, tik-ta...
Një sekondë,
një minutë,
një orë.
Rruga e saj ende vazhdon.
Rruga e saj ende vazhdon...

Akrepat na tregojnë
sa është ora,
diçkë numërojmë në kalendar.
Një javë,
një muaj, një vit.
Koha fluturon
pa u ndalur asnjë sekondë.

1. Ku tregohen ditët, javët dhe muajt?
2. Ku tregohen sekondat, minutat dhe orët?
3. Përpiqu të bësh prej kartoni tri orë të tilla:

E para të tregojë orët.
E dyta të tregojë ditët e javës.
E treta të tregojë muajt e vitit.

Kërmilli dhe miu

Një kërmill po shëtiste në fushë. Ai mbante mbi shpinë shtëpizën e tij.
Tek zvarritej, ai takoi miun. Miu i habitur nga ajo që pa, i tha me tallje:
- Sa i marrë që je, mortorollak! Ç'të duhet ta mbash në shpinë shtëpizën?
Nuk të rëndon ajo?
Kërmilli nuk foli, por vazhdoi rrugën, pa u vënë veshin fjalëve të miut.
Pas pak filloi të binte shi. Kërmilli i mençur u strehua në shtëpizën e tij.
Ai mbylli dyer e dritare. Ndërsa miu i giorë u bë qull nga shiu.

Ngjyros kërmillin.

1. Ku po shëtiste kërmilli?
2. Kë takoi ai rrugës?
3. Pse miu e talli kërmillin?
4. Çfarë ndodhi kur filloi shiu?